

VENDIM
Nr.4, datë 7.1.2005

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS PREZË, TIRANË TË REPARTIT USHTARAK NR.3800/1, BATALIONI “AKA” NË PREZË, TIRANË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-repartit ushtarak nr.3800/1, batalioni “AKA” në Prezë, Tiranë të kalojnë në pronësi të komunës Prezë, Tiranë, për t’u përdorur për shërbimet sociale të komunitetit të kësaj komune.

2. Prona me numër rendor 210 “Ish reparti ushtarak nr.3800/1, batalioni “AKA”” në Prezë, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komunës Prezë, Tiranë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i komunës Prezë, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano